

Raporti i rasteve të korrupsionit

Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore

QYTETARËT > AVOKIMI > NDRYSHIMET

2009

PERSONELI:

Ismet KRYEZIU - Drejtor ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës
dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë
dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Emine BEHLULI - Asistente për administratë
dhe financa
email: ebehluli@kdi-kosova.org

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Admir ISTREFI - Asistent Programi
email: aistrefi@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Zyrtar për marrëdhënie
me publikun
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Sahit BIBAJ - Avokat / Këshilltar juridik
email: sbibaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Vullnetare
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

Visar RAMAJ - Vullnetar
email: vramaj@kdi-kosova.org

Liridon SELMANI - Monitorues
email: lselmani@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:

Valmir ISMAILI - Menaxher programi
email: vismaili@kdi-kosova.org

Driton SELMANAJ - Asistent i programit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Fitore ZENELI - Asistente e programit
email: fzeneli@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Monitorues
email: izejna@kdi-kosova.org

Ramadan KLISURICA - Monitorues
email: rklisurica@kdi-kosova.org

Rrezarta AHMETI - Monitorues
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - Menaxher programi
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Nora VESELI - Koordinator
email: nveseli@kdi-kosova.org

BASHKËPUNËTOR TË JASHTËM

Arsim GJINOVCI - IT & design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

Yll BULESHKAJ - Analist
email: ybuleshkaj@kdi-kosova.org

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Metodologjia	5
Përmbledhje ekzekutive	6
Korrupsioni në sektorë të ndryshëm	9
Niveli i korrupsionit sipas sektorëve	9
Format e paraqitjes së korrupsionit në Kosovë	11
Raporti nga databaza e rasteve të korrupsionit.....	12
Mënyra e informimit të qytetarëve mbi mekanizmat anti-korrupsion	29
Mënyra se si qytetarët kanë kontaktuar QAKL-në	30
Raportuesit e korrupsionit sipas gjinisë	31
Raportuesit e korrupsionit sipas vendbanimit.....	32
Konkluzione	33

HYRJE

Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) është program që është themeluar nga Instituti Demokratik i Kosovës në dhjetor të vitit 2008. Qendra funksionon në kuadër të Institutit Demokratik ku si qëllim kryesor ka luftën kundër korrupsionit. Partneri kryesor i kësaj qendre është organizata Transparency International (TI), e cila është organizatë globale e shoqërisë civile dhe lidere botërore në luftë kundër korrupsionit.

Korrupsioni paraqet një fenomen me ndikime të jashtëzakonshme negative për një vend. Korrupsioni duke ndikuar në dobësimin e sundimit të ligjit, zbatimin e reformave dhe ndikimin e interesave personale në funksionimin e institucioneve, paraqet pengesë të madhe në zhvillimin ekonomik dhe të demokracisë së një vendi. Për më tepër, sipas Transparency International (TI), janë shtresat e varfra ato që më së shumti pësojnë në vendet me nivel të lartë të korrupsionit. Ndërsa në terma konkret, sipas Bankës Botërore, po që se një vend merret seriozisht me luftë kundër korrupsionit mund të presë në periudhën afat-shkurtër të ketë rritje të të ardhurave për kokë banori deri në 400%. Andaj edhe për Kosovën si një vend me zhvillim të ulët ekonomik dhe me aspirime për integritet euro-atlantik është e një nevojë të jashtëzakonshme luftimi i korrupsionit.

Për Kosovën korrupsioni paraqet një problem mjaft serioz. Kosova momentalisht ballafaqohet me nivel të lartë të përhapjes së korrupsionit, mungesë të vullnetit politik për të luftuar korrupsionin në mënyrë serioze, me një sistem gjyqësor të dobët dhe të korruptuar dhe me mungesë të infrastrukturës ligjore anti-korrupsion. Problemet e lartpërmendura të Kosovës me korrupsionin evidentohen edhe nga raportet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Kështu, sipas Raportit të Progresit të

Komisionit Evropian për vitin 2009, në Kosovë përpos që kemi nivel të lartë të përhapjes së korrupsionit evident është edhe angazhimi i pamjaftueshëm i qeverisë sonë dhe institucioneve tjera përgjegjëse për luftimin e korrupsionit. Sa i përket organizimit të luftës kundër korrupsionit, Raporti i Progresit i vitit 2009 nga Komisioni Evropian vlerëson se; bashkëpunimi në mes aktorëve të angazhuar në këtë luftë duhet të përmirësohet në mënyrë thelbësore. Gjithashtu, Raporti i Progresit ngrit dyshime mbi strategjinë kombëtare për luftimin e korrupsionit, të cilën strategji e konsideron me fuqi veprimi të kufizuar.

Burim tjetër i besueshëm ndërkombëtar për vlerësimin e gjendjes në Kosovë është Raporti i organizatës Transparency International "Barometri Global i Korrupsionit 2009". Barometri jep të dhëna konkrete mbi shkallën e korrupsionit në një vend bazuar në perceptimet e qytetarëve. Sipas këtij raporti shkalla 1 paraqet një vend pa korrupsion, përderisa shkalla 5 paraqet një vend me nivel ekstrem të korrupsionit. Kosova në vitin 2009 shënon rezultatin prej 3.4. Derisa institucioni më i korruptuar paraqitet gjyqësori me rezultat prej 4.0 duke u pasuar nga partitë politike me rezultat 3.8. Nëse si indikator të korrupsionit përdoret kriteri mito (ryshfeti), në Kosovë del se 13% e qytetarëve kanë paguar mito në 12 muajt e fundit për të siguruar shërbime që do të duhej të siguroheshin falas.

Bazuar në këtë gjendje në të cilën gjendet Kosova, QAKL-ja është e vetëdijshme se për luftim të suksesshëm të korrupsionit nevojitet përkushtim i madh i të gjitha segmenteve të shoqërisë kosovare, e ndër ta edhe i shoqërisë civile. Përmes publikimit të Raportit vjetor mbi rastet e Korrupsionit duke u ofruar të dhëna institucioneve shtetërore mbi funksionimin e korrupsionit, QAKL-ja synon të jap kontributin në organizimin e një lufte më të

efektshme kundër korrupsionit, e sidomos në përmirësim të politikave, legjislacionit dhe praktikave në fushat ku shfaqet korrupsioni. Këto të dhëna që u ofrohen organeve shtetërore përfshijnë informata mbi institucionet të cilat janë më tepër të prekura nga korrupsioni, informata mbi atë se si funksionojnë mekanizmat e këtij fenomeni dhe të dhëna tjera statistikore lidhur me rastet e denoncuar në QAKL.

METODOLOGJIA

Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) funksionon në bazë të katër komponentëve: a) lidhjen me qytetarë dhe biznese për denoncimin e rasteve të korrupsionit b) ofrimin e këshillave ligjore profesionale falas c) avokim në bazë të rasteve të paraqitura, dhe d) ofrimin e asistencës për autoritet shtetërore në ngritje të kapaciteteve. Qasja e QAKL-së ndaj luftimit të korrupsionit ka të bëjë me lidhjen e drejtpërdrejt me qytetarë të thjeshtë apo biznese të cilët hasin në fenomenin e korrupsionit. Duke synuar që të arrihet kjo lidhje me qytetarë, qendra është një mekanizëm që ofron mënyra të përshtatshme dhe të sigurta për raportimin e korrupsionit. Ndër këto mënyra përfshihet linja telefonike pa pagesë në numrin **0800 201 301** që është aktiv çdo ditë pune, ndërsa mënyrat e tjera që janë përdorur më pak janë adresa elektronike dhe letrat postare.

Në kuadër të funksionimit të QAKL-së përfshihen publikime lidhur me funksionimin e mekanizmave të korrupsionit dhe të dhëna tjera statistikore lidhur me fenomenin e korrupsionit. Të gjitha këto të dhëna gjenerohen nga informatat e qytetarëve që kontaktojnë drejtpërdrejt me QAKL-në të cilat regjistrohen në databazën e evidentimit të rasteve të korrupsionit ,

dizajnuar nga ana e Transparency International (TI). Këto raporte lidhur me rastet e korrupsionit dhe funksionimin e mekanizmave të korrupsionit janë raporte periodike gjashtë mujore dhe raporte vjetore. Që nga fillimi i punës së QAKL-së është bërë publikimi i një raporti gjashtë mujor, përderisa ky është raporti i parë vjetor që publikohet nga QAKL.

Në kuadër të këtij raporti vjetor përfshihen të gjitha denoncimet për korrupsion që janë bërë në qendër për periudhën Janar – Dhjetor 2009. Numri i përgjithshëm i rasteve që janë raportuar si raste të dyshuara për korrupsion gjatë kësaj periudhe është 102 raste. Të dhënat e paraqitura më poshtë në raport janë nxjerrë nga regjistri i të dhënave në databazë, ku si kriteret për klasifikim kanë shërbyer:

- a) Fusha/institucioni ku raportohet për korrupsion
- b) Mekanizmat se si funksionon korrupsioni si fenomen
- c) Lokacioni prej nga vjen denoncimi
- d) Gjinia e denoncuesit
- e) Mënyra e trajtimit nga ana e qendrës
- f) Mënyra se si informohen qytetarët për mekanizmat anti-korrupsion
- g) Mënyra se si qytetarët kontaktojnë mekanizmat anti-korrupsion

QAKL në mandatin e saj është e kufizuar që të zhvilloj hetime lidhur me rastet e raportuara të korrupsionit, pra për rastet e paraqitura si të dyshuara qendra nuk zhvillon hetime për tu siguruar për vërtetësinë. QAKL në metodologjinë e punës së saj përfshin ofrimin falas të ndihmës ligjore, këshillim lidhur me kompletimin e dokumentacionit dhe udhëzime për përgatitjen e lëndës për raportim, si rast të korrupsionit në organet

kompetente të hetuesisë. Në anën tjetër nga informatat e ofruara, QAKL-ja zhvillon avokim lidhur me mangësitë ligjore dhe institucionale që mundësojnë zhvillimin e korrupsionit në formën e raportuar.

Varësisht se si qaset, korrupsioni si fenomen dhe si nocion ka kuptime të ndryshme. QAKL në punën e saj, për termin korrupsion përdor definicionin nga Transparency International (TI) i cili thotë se: "korrupsion do të thotë të abuzosh me detyrën e besuar për përfitim personal". Pra si raste korruptive QAKL-ja i klasifikon të gjitha rastet e dyshuara që përmbushin këto dy kushte, abuzimin me detyrën e besuar, dhe ekzistimin e një interesi për përfitim personal.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

"Raporti vjetor i rasteve të korrupsionit" (Raporti vjetor) publikuar nga Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) është një prej instrumenteve që përdoret për të sensibilizuar opinionin publik dhe institucionet shtetërore mbi funksionimin e korrupsionit në vend. Në këtë raport paraqiten të dhënat e përpunuara nga rastet e raportuara të korrupsionit nga ana e qytetarëve dhe përfshijnë periudhën kohore Janar – Dhjetor 2009. Numri i përgjithshëm i rasteve që janë raportuar në qendër dhe që janë përpunuar në këtë raport është 102.

Raporti përfshin analizën e të dhënave lidhur me: sektorët/institucionet ku janë raportuar raste të korrupsionit, vendbanimi prej nga raportohet korrupsionin, gjinia e raportuesit, mënyra se si qytetarët kanë dëgjuar për

QAKL-në si dhe mënyra se si qytetarët kanë komunikuar me QAKL-në.

Përfundimet e nxjerra nga Raporti vjetor i vitit 2009 janë:

Gjyqësia është institucioni ku janë raportuar më së shumti raste të korrupsionit

Raporti nxjerr përfundimin se në Kosovë institucionet/ sektorët me nivel më të lartë të korrupsionit paraqiten gjyqësori me 19% të rasteve të raportuara, edukimi 12%, drejta pronësore 11%, sektori privat 11%, prokurimi publik 8%, inspekcione/licenca 8%. Pas këtyre institucioneve, numër më i vogël i rasteve të korrupsionit janë raportuar në ndërmarrje publike 5% të rasteve, privatizimi 3%, policia 3%, shërbime komunale 2%, Shëndetësi 2%, dogana 1% dhe të tjera.

Një shkallë kaq e lartë e rasteve të raportuara të korrupsionit në gjyqësi është shqetësuese. Sektori i gjyqësisë si një ndër shtyllat themelore të funksionimit të ligjit në një vend do të duhej të ishte garantues i sundimit të ligjit dhe t'i dënonte personat që kryejnë veprat penale të korrupsionit. Por, gjyqësori i dobët dhe me nivel të lartë të korrupsionit në një formë lejon mundësi të zhvillimit të korrupsionit edhe në sektorët tjerë. Korrupsioni në gjyqësi shërben edhe si një lloj motivuesi për zhvillimin e korrupsionit edhe në sektorë tjerë bazuar në mundësin që mund të korruptohet edhe vetë gjyqësori si institucion dhe të ndikohen vendimet e tij.

Nëse raporti vjetor krahasohet me raportin Gjashtë Mujor të korrupsionit të publikuar po nga QAKL-ja ndryshimi në shpërndarjen e denoncimeve të korrupsionit sa i përket sektorëve/Institucioneve është i vogël. Ky është një indikator që tregon se përderisa ankesat shtrihen në të

njëjtat fusha si më të ndikuarat nga korrupsioni ato edhe realisht janë më problematike për Kosovën.

Numri më i madh i raportimeve të korrupsionit vjen nga vendet urbane

Një klasifikim i përdorur lidhur me raportimet e pranuar bazohet në kriterin e vendbanimit prej nga thërrasin raportuesit. Rezultatet tregojnë nivel shumë më të lartë të raportuesve që thërrasin nga vendet urbane (qytetet kryesore), ku kjo strukturë përbën rreth 47% të numrit të përgjithshëm. Raportuesit me vendbanim në vendet rurale përbëjnë vetëm 9% të numrit përgjithshëm të raportuesve. Pjesa tjetër e raportuesve përbëjnë vendet gjysmë-urbane ku janë klasifikuar qytezat (komunat) tjera të Kosovës, duke mos përfshirë këtu shtatë qendrat kryesore (qytetet kryesore).

Raportuesit e korrupsionit të gjinisë mashkullore dominojnë me 85%

Raporti vjetor nxjerr përfundimin se në Kosovë dominojnë raportuesit e gjinisë mashkullore kundrejt raportuesve të gjinisë femërore. Kështu nga numri përgjithshëm i rasteve të raportuara, 85% të raportuesve kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe vetëm 15% të gjinisë femërore. Edhe pse janë një numër i vogël i raportuesve të gjinisë femërore, rastet që i kanë raportuar kanë qenë në institucione të ndryshme dhe nuk ka pasur ndonjë sektorë specifik ku kanë mundur të koncentrohen ankesat e tyre.

Televizioni është mjete më i shpeshtë prej nga qytetarët janë informuar për QAKL-në

Duke marrë parasysh që QAKL-ja si bazë të punës së saj ka denoncimet që vijnë nga qytetarët, mënyra se si qytetarët janë informuar lidhur me mekanizmat anti-

korruption, më konkretisht me programin e QAKL-së, është e një rëndësie të veçantë. Këto të dhëna tregojnë një lidhje të fortë të opinionit kosovar me televizionin si mjet komunikimi, ku 50% e personave që kanë raportuar, informatat mbi programin e QAKL-së i kanë marrë nga televizioni. Mënyra tjera të informimit kanë përfshirë promovimin që është bërë në terren që ka rezultuar me 8% të rasteve të raportuara, artikuj në gazeta 6%, radio 6% etj.

Telefoni është mënyra kryesore se si qytetarët kanë raportuar korrupsionin në QAKL

Duke analizuar mënyrën se si qytetarët kontaktojnë me QAKL-në, pra çfarë mjete të komunikimit përdorin, raporti vjetor jep një përfundim se linja telefonike pa pagesë është metoda që më së shpeshti është përdorur nga publiku kosovar për raportimin e korrupsionit në QAKL. Kështu telefonin e kanë përdorur 93% e rasteve që kanë raportuar korrupsion, 4% kanë bërë vizita direkte në qendër, 2% kanë përdorur e-mail dhe 1% letrat postare.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) nuk mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në raport pasi ato paraqiten ashtu si janë raportuar nga qytetarët. kjo pasi kdi nuk ka mandat për hetim të rastve. Për rastet e paraqitura janë bërë përpjektje maksimale për të siguruar vërtetësinë e tyre.

KORRUPSIONI NË SEKTORË TË NDRYSHËM


Niveli i korrupsionit sipas sektorëve

Bazuar në denoncimet mbi rastet e korrupsionit të pranuar gjatë vitit 2009, raporti vjetor i QAKL-së tregon se institucionet më të prekura nga korrupsioni në Kosovë janë: gjyqësia, edukimi, sektori privat, lëmia e të drejtave pronësore, e përcjellur nga prokurimi publik dhe fusha e inspekcioneve/licencave.

Gjyqësia paraqitet si institucioni më i korruptuar në Kosovë me 19% të rasteve të paraqitura nga numri i përgjithshëm. Për më tepër gjyqësia paraqitet si ankesë dytësore edhe në raportimet për fushat tjera. Ankesa dytësore ka kuptimit kur fenomeni i korrupsionit është

prezent në një fushë të caktuar, por në ndonjë formë është e përfshirë edhe gjyqësia si p.sh. kërkohet mito për praninë në punë dhe kur për këtë rast pala i drejtohet gjykatës, por lidhjet e ndryshme familjare mes palës së paditur dhe gjykatësit lënë dyshime për keqpërdorim të procesit dhe korrupsion në gjykatë. Kështu, si ankesë dytësore gjyqësia paraqitet në 16% të rasteve.


Niveli i këtillë i përhapjes së korrupsionit në gjyqësi është shqetësues. Në luftën kundër korrupsionit një sistem i fortë gjyqësor do të shërbente edhe si mjet parandalues i fenomenit të korrupsionit përpos faktit që do të siguronte që në rast shkeljesh të gjykonte fajtorët. Gjyqësia duke mos e përmbushur këtë funksion esencial të saj kontribuon në një nivel kaq të lartë të korrupsionit dhe në një perceptim që pasurimi përmes korrupsionit mund të kalohet pa u dënuar.



Mënyrë për të testuar se a janë përfaqësuese vlerësimet e QAKL-së mbi institucionet me nivel më të lartë të korrupsionit është edhe krahasimi i raportit vjetor me raportet e mëhershme, më konkretisht me raportin gjashtë mujor të rasteve të korrupsionit. Nga një analizë e tillë vërehet që diferencat e numrit të denoncimeve për korrupsionin në institucione janë të vogla. Ky është një indikator që tregon se përderisa ankesat nëpër institucione si më të ndikuarat nga korrupsioni shtrihen në mënyrë përafërsisht të njëjtë për periudha të caktuara kohore ato edhe realisht janë më problematike për Kosovën.

Lidhur me përhapjen e korrupsionit në fushat të cilat QAKL-ja i paraqet si më të korruptuarat ekziston mbështetje edhe nga raportet tjera vendore dhe

ndërkombëtare. Transparency International (TI) duke matur perceptimin e qytetarëve erdhi në përfundim se qytetarët e Kosovës si institucionin më të korruptuar e shohin gjyqësinë. Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit (AKK) vlerëson se gjyqësia është pengesa më e madhe në luftë kundër korrupsioni. Edhe Raporti Progresit i nga Komisioni Evropian vlerëson se, sistemi i drejtësisë mbetet i dobët, i ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve politike dhe joefikas. përderisa ka vërejtur probleme edhe në menaxhimin me paranë publike.



FORMAT E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Funksionimi i mekanizmave të korrupsionit në Kosovë paraqet ndër pjesët kryesore të raportit vjetor të QAKL-së. Si qëllim ka të paraqes mënyrat se si funksionojnë mekanizmat e korrupsionit në Kosovë dhe cilët janë treguesit apo praktikët të cilat flasin për prezencë të korrupsionit. Prandaj, analizimi i fenomenit të korrupsionit, nga rastet që janë raportuar në QAKL-ë, bëhet për secilin sektor dhe duke përfshirë këto dy komponentë: a) pjesë që tregojnë për raste dhe mekanizma konkret të korrupsionit, dhe b) tregues nga veprimtaria e organeve të ndryshme për mundësi të prezencës së korrupsionit. Fokusimi edhe në indikatorë të korrupsionit është një metodologji që mundëson informata më të shumta dhe të vlefshme për organizim më të suksesshëm të luftës anti-korrupsion.

Sipas raportit vjetor, institucionet me nivel më të lartë të korrupsionit janë gjyqësia, edukimi, sektori privat, të drejtat pronësore, prokurimi publik, inspeksioni/ licencat dhe ndërmarrjet publike. Sa i përket mekanizmave se si zhvillohet korrupsioni në këto institucione, në përgjithësi praktikët më të përhapura janë: mitoja, familjarizmi, prokurimet publike, largime arbitrare nga puna dhe manipulime të konkurseve për praninë në punë etj. Fenomeni i mitos në praktikë shfaqet me ofrimin e shërbimeve publike që duhet të ofrohen falas kundrejt shpërblimit në të holla. Formë tjetër e korrupsionit shfaqet edhe sigurimi i ndonjë favorit apo shërbimi tjetër jo-ligjor nga organet publike kundrejt një pagese apo kundër favorit.

Fenomeni i mitos është i përhapur sidomos në institucionet publike. Fenomeni i familjarizmit është një tjetër fenomen shumë i përhapur dhe i lidhur ngushtë me afëra korruptive. Në radhë të parë këtu paraqiten punësimet e familjarëve pa kriterë në institucione publike, dhe në anën tjetër largimet arbitrare nga puna. Si formë tjetër e fenomenit të familjarizmit paraqitet edhe shfrytëzimi i këtyre lidhjeve për sigurimin e favoreve të ndryshme, sikurse janë shembujt e gjyqësisë. Po ashtu në lidhje me fenomenin e familjarizmit është raportuar edhe shfrytëzimi i këtyre lidhjeve për të monopolizuar menaxhmentin vendimmarrës dhe për të kontrolluar këto organizata. Procesi i prokurimit publik po ashtu karakterizohet me mekanizma mirë të formuar të korrupsionit që si ndikim final kanë keqpërdorimin e parasë publike për interesa personale. Në kuadër të prokurimit publik janë të njohur mekanizmat përmes të cilëve shfrytëzohet autoriteti dhe pozita për fitim dhe anulim të kontratave bëhet faturimi mbi vlerën reale, bëhen shpenzime të regjistruara më tepër se vlera që mbyllet me dëshmi etj.

Një fenomen shqetësues që lidhet me funksionimin e korrupsionit në Kosovë ka të bëjë me trajtimin e personave që merren me afëra korruptive. Këta persona përpos që shfrytëzojnë dobësitë e mekanizmave anti korrupsion dhe mos-efikasitetin e sistemit gjyqësor përdorin edhe mundësinë e ndërrimit të vendit të punës në administratën publike për t'i ikur përgjegjësisë së mundshme. Kështu, QAKL-ja është vënë në dijeni të rastit kur personi i cili është larguar nga një vend i punës për shkak të dyshimeve për korrupsion dhe keqpërdorimeve që ka bërë, ka kaluar në një institucion tjetër dhe vazhdon të punojë pa dhënë asnjë përgjegjësi për dëmet që ka shkaktuar dhe veprën që ka kryer.

Korrupsioni paraqet një fenomen kompleks ku si vështirësi primare për organizmat që nuk kanë mandat

hetimi, sikurse është edhe QAKL-ja, paraqitet sigurimi për të vërtetën lidhur me rastin e denoncuar. Për rastet e paraqitura në raport QAKL-ja është ofruar me të dhëna dhe argumente mbështetëse, mirëpo QAKL-ë nuk mund të garantojë vërtetësinë e tyre dhe të mbajë përgjegjësi për përdorimin e këtyre fakteve nga persona të tretë për çfarëdo qëllimi.

GJYQËSIA

19% të rasteve të raportuara

Gjyqësia në Kosovë karakterizohet me përhapje të gjerë të korrupsionit, nivel të ulët të zbatimit të reformave, mungesë të rregullimit adekuat ligjor dhe ndërhyrje nga jashtë. Një numër i konsiderueshëm i denoncimeve lidhur me korrupsion në sistemin e drejtësisë janë të lidhura me konteste civile, pronësore dhe trashëgimore. Niveli i lartë i korrupsionit në sistemin e gjyqësisë ilustruhet edhe me të dhënat e Raportit të Barometrit Global të Korrupsionit 2009 nga TI, ku tregohet se 8% e qytetarëve të Kosovës kanë paguar mito gjatë kontaktit të tyre me sistemin e gjyqësisë.

Ndër praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë:

- **Lidhjet familjare dhe ndikimet nga jashtë**

QAKL-ja ndër mekanizmat kryesor të funksionimit të korrupsionit në gjyqësi ka vërejtur se është mundësia e ndikimit nga jashtë dhe ekzistimi i lidhjeve familjare mes palëve në kontest dhe gjyqarit. Në sistemin e gjyqësisë ndarja e rasteve mes gjyqtarëve rregullohet nga vetë gjykata e caktuar përmes metodave manuale e që lidhen me numrin e regjistrimit të lëndës. Dhe pikërisht në këtë fazë, në momentin kur lëndët arrijnë për regjistrim, u

ndërrohet radha dhe u caktohen gjyqtarëve të caktuar. Pra nëse një gjyqtar është i interesuar të gjykojë një rast për ndonjë interes të caktuar shumë lehtë mund ta marrë në gjykim atë rast. Është brengosës fakti se edhe pse për zgjidhje të këtij problemi ka disa vite që është paraparë hyrja në funksion e një sistem elektronik të menaxhimit të lëndëve, sistem ky që ende nuk ka hyrë në funksion për shkak të neglizhencës së organeve kompetente.

- **Zgjidhjet e ndryshme për raste të njëjta**

Shumë shqetësuese paraqitet praktika e gjykatave që për rastet përafërsisht të njëjta marrin vendime (aktgjykimi) të ndryshme. Në Kosovë gjykatat ende nuk kanë krijuar një praktikë të njëjtë të vendim-marrjes për rastet shumë të ngjashme. Për më tepër, ky është një indikator për mundësinë e prezencës së ndikimit të jashtëm, interesave personale apo korrupsion si mundësi me probabilitet më të madh. Përderisa në një anë kemi vendime të ndryshme në raste të ngjashme, në anën tjetër ekzistojnë edhe vendime shumë kontradiktore të gjykatave, interpretimi i të cilave dërgon në përfundimin e mundësisë së ekzistimit të korrupsionit apo interesave tjera të ngushta. Si shembull ilustrues mund të shërbejnë informatat e ofruara në QAKL-ë nga media të cilët merren me monitorim gjyqësori, më konkretisht rasti ku një person për shkak të vjedhjes së një kasetofoni dënohet me 2.5 vite burgim, derisa në rastin tjetër personi për trafikim të qenieve njerëzore dënohet me 7 muaj burgim.

- **Tejzgjatja e procedurave gjyqësore**

Lëndët që lidhen me konteste të ndryshme civile, pronësore dhe trashëgimore janë lëndë që në sistemin gjyqësor të Kosovës nuk zgjidhen me vite të tëra. Në QAKL janë trajtuar palë të cilët për më tepër se 10 vite kanë pasur lëndë në procedurë gjyqësore. Kjo zvarritje në të shumtën e rasteve i vendosë qytetarët në pozitë që të kërkojnë

zgjdhje në rrugë tjera për lëndët, ndër to më së shpeshti përmes korrupsionit – mitos. Andaj ekzistojnë dyshime se për përsheptim të procedurave ndër format e përdorura shërben edhe dhënia e mitos.

- ***Përsheptimi i procedurave gjyqësore***

Përderisa në një anë kemi një sistem gjyqësor i cili është jo-efikas dhe lëndët zgjatin për kohë të gjata, në praktikë QAKL-ja ka hasur në raste kur lëndët civile, pronësore apo trashëgimore janë kryer brenda pak ditëve apo javëve. Kjo praktikë është në kontrast me procedimin e zakonshëm të lëndëve në gjykata, ku deri në zgjedhje përfundimtare lënda do të duhej të priste me vite. Kjo praktikë e përsheptimit të pazakonshëm të procedurave është indikatorë se në zgjidhjen e atyre lëndëve duhet të ketë pasur ndonjë ndikim apo “stimulin” nga jashtë, ku si mundësi janë edhe mito apo forma tjera të korrupsionit.

- ***Mos përmbartimi i vendimeve të gjykatave***

Në mesin e raportimeve për prani të korrupsionit që lidhen me sistemin e drejtësisë është edhe mos përmbartimi i vendimeve të gjykatave, edhe pse për to ekzistojnë aktvendime të formave të prera. Këto praktika në të shumtën e rasteve arsyetohen me mos efikasitet dhe numër të vogël të stafit të gjykatave për përmbartime. Por edhe këtu, sikurse në zgjidhjen e lëndëve në gjykata, ka raste kur lëndët e caktuara zgjidhen shumë shpejt, e lëndët tjera zvarriten në periudha shumë të gjata. Raste të tilla të trajtuara nga QAKL-ja kanë pasur të bëjnë me situatat kur ka ekzistuar një vendim i formës së prerë, me të cilin vendim organi i caktuar detyrohet të bëjë bartjen e një shume të mjeteve tek pala tjetër, por përderisa organi në fjalë nuk e bën një veprim të tillë gjykata tej zgjat procedurat për përmbartim.

- ***Mos respektimi i kodit të etikës***

Si mos respektim i kodit të etikës mund të klasifikohen shumë veprime, mirëpo me interes për këtë raport janë ato veprime që në mënyre indirekte mund të tregojnë korrupsion. Kështu, në kuadër të këtyre veprimeve hyjnë: komunikimi i qëndrimit të gjyqtarit ende pa filluar gjykimet, ofendimet e njëjës prej palëve, përdorimi i shpeshtë i telefonit mobil gjatë seancës dhe ndryshimi rrjedhës së seancës pas telefonatave të pranuar, përdorimi i duhanit etj. Ndër këto raste si më brengosëse paraqiten ofendimet e njëjës prej palëve nga ana e gjyqtarit dhe në raste më të rënda edhe komunikimi në lidhje me atë se çfarë vendimi do të merr gjyqtari edhe pse gjykimet ende nuk kanë filluar.

REKOMANDIME:

1. Implementimi sa më shpejtë i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve;
2. Miratimi i ligjit të ri për organizimin e gjykatave dhe prokurorive;
3. Funkcionalizimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për administrimin dhe kontrollin e gjyqësorit;
4. Ngritje kapacitetesh të Inspektoriatit Gjyqësor të Kosovës;
5. Fleksibilitete dhe transparencë në shqyrtimin e kërkesave të palëve për përjashtim të gjyqtarit në raste kur dyshohet për konflikt interesi;
6. Parashikimi i sanksioneve në rastet kur gjyqtarët nuk paraqesin vullnetarisht dorëheqjen në rastet kur gjykimi të cilin e udhëheqin paraqet konfliktit të interesit;
7. Ngritje e kapaciteteve të gjykatave për përmbartimin e lëndëve;
8. Krijimi i praktikave të vendim-marrëse të njëjta në raste të cilat janë shumë të ngjashme;

Rast suksesi nga Gjyqësia

Gjyqësia është sektori më i korruptuar bazuar në raportimet e të bëra tek TI. Ankesat kanë pasur të bëjë me raste të keqpërdorimeve të lidhjeve familjare mos gjyqtarit dhe njëerës nga palët, ndikimi nga jashtë, vendime të ndryshme për raste shumë të ngjashme, tejzgjatje e gjykimeve, përshpejtim i procedurave si rezultat i korrupsionit etj. Në pamje të parë, disa nga rastet e përmendura më lartë, mund të duket që nuk janë të lidhura me korrupsion dhe të interpretohen si mungesë e efikasitetit ose mungesë e stafit, por nëse analizohen më thellë një tjetër pamje shfaqet që tregon për mekanizma të korrupsionit. Sa ka pasur të bëjë me raste të tilla, TI Kosova I trajtuar në dy mënyra:

a) Ndhimë ligjore falas në rastet e tyre specifike

b) Ndërmarrja e një studimi mbi sistemin gjyqësor dhe mekanizmat e korrupsionit

a) Një nga principet e punës së TI Kosovës është të ndihmoj qytetarët me çështjet e tyre specifike. Në shumë raste qytetarët ishin të frustruar me procedurat gjyqësore të tyre dhe vështirësitë që kishin hasur. Si shembull, kanë qenë rastet që kanë pasur të bëjë me shkeljen e kodit të etikës kur gjyqtari, para se është marrë vendimi, fyen një nga palët dhe I informon se kur nuk mund të fitojnë rastin. Rastet tjera kanë qenë të ndërlidhura me tejzgjatjen e gjykimeve, përshpejtimin e procedurave në raste të caktuara, përdorimin e lidhjeve familjare, ndikimin nga jashtë në vendimet e gjykatës përmes ndikimit nga jashtë apo dhënies së mitos.

Në këto raste, zyra e TI në Kosovë ka këshilluar qytetarët varësisht nga karakteristikat e rasteve të tyre. Këshilla janë ofruar sidomos në rastet e përgatitjes

së dokumentacionit për fillimin e procedurave për largimin e gjykatësve, sidomos dokumenteve dhe provave që duhet ekzistojnë. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të kodit të etikës, qytetarët janë ndihmuar në përgatitjen e lëndëve dhe dorëzimin e tyre në Inspektoratin Gjyqësor, për faktin se ky i fundit nuk ka qenë efikas. Në disa raste që ndërlidheshin me tejzgjatjen e gjykimeve, qytetarët janë ndihmuar në hartimin e urgjencave drejtuar gjykatave për përshpejtimin e procedurave.

b) Paralelisht me këshillimin e qytetarëve, zyra e TI në Kosovë zhvilloi një studim mbi sistemin gjyqësor, kornizën institucionale të tij dhe funksionimin e mekanizmave të korrupsionit. Të dhënat e studimit tregojnë se arsyetimi i mos efikasitetit të institucioneve të gjyqësisë me numrin e limituar të personelit, nuk qëndron. Studimi shpalos faktin se në sistemin gjyqësor të Kosovës aktualisht punojnë 14.2 gjykatës në 100.000 banorë, përderisa në Shqipëri numri i gjykatësve në 100.000 banorë është 7.4, në Francë 11.1 ndërsa në Rumani 15.7. Një konstatim tjetër i raportit të studimit është se mekanizmat e korrupsionit zënë vend në fazat e para të procesit, respektivisht në momentin e ndarjes së lëndëve në mes të gjykatësve. Në këtë fazë mungon një sistem objektiv për shpërndarjen e lëndëve, gjë që u mundëson gjykatësve të zgjedhin lëndët me interes të cilat duan ti drejtojnë. Kjo njëkohësisht u mundëson palëve të influencojnë procedimin e lëndëve në gjykatë. Studimi gjithashtu shpalos shumë problemeve të tjera që ndërlidhen me korrupsionin, duke konstatuar se mungon bashkëpunimi institucional në mes të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Gjithashtu, shkalla e ulët e profesionalizmit në mesin e gjykatësve dhe mungesa e mekanizmave për monitorimin e sistemit të gjyqësisë janë fenomene mjaft shqetësuese.

EDUKIMI

12% të rasteve të raportuara

Korrupsioni në sektorin e edukimit paraqitet në nivel mjaft të lartë, është fusha e dytë më e korruptuar pas gjyqësisë. Korrupsioni në sektorin e edukimit nuk ka qenë pjesë e ndonjë analize të themelt në Kosovë dhe nuk i është dhënë ndonjë kujdes i veçantë nga organet shtetërore. Një argument i mundshëm që e arsyeton mungesën e fokusimit në luftën kundër korrupsionit në edukim mund të jetë që krahasuar me gjyqësorin dhe prokurimin publik apo të drejtat pronësore nuk është me vlerë të madhe monetare. Mirëpo, numri kaq i madh i raportimeve për korrupsion dhe mekanizma e formuar të funksionimit të këtij fenomeni do të duhej të ishin një sinjal për një intervenim nga organet shtetërore.

- **Fenomeni i familjarizmit**

Fenomeni i familjarizmit është fenomen me të cilin ka problem edhe sistemi edukimit në Kosovë. Ky fenomen është sidomos i shprehur në kushtet kur ndonjëri prej familjarëve ka pozitë të lartë, qoftë në shkollë, qoftë në organe tjera të sistemit arsimor. Në raste të kushteve të tilla, personi që është në pozitë të lartë udhëheqëse shfrytëzon autoritetin e tij për të punësuar njerëz të afërt të tij. Në QAKL janë raportuar edhe raste kur në të njëjtën shkollë kanë punuar dy prindërit dhe fëmija i tyre, përderisa njëri prej tyre ka qenë në pozitë udhëheqëse.

- **Modifikim i konkurseve për pranim në punë**

Rasti i modifikimit dhe manipulimit të konkurseve për pranim në punë është raportuar nga palë të ndryshme në QAKL. Këto raportime kanë pasur të bëjë me raste kur pasi bëhet publik konkursi dhe konkurrojnë individë të

ndryshëm ai anulohet, derisa më vonë prapë rishpallet i modifikuar me kushte speciale në mënyrë që t'i përshtatet një individ të caktuar. Në raste tjera, edhe pse konkursi parasheh kriteret specifike të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët, punësohen kandidatë të cilët nuk i plotësojnë ato kriteret duke anashkaluar kandidatët adekuatë. Rastet e modifikimit të konkurseve janë ngushtë të lidhura me fenomenin e familjarizmit dhe dyshimeve për korrupsion.

- **Mito në administratën e shkollave**

Fenomeni i mitos në administratën e shkollave është fenomen i shprehur dhe i lidhur me lëshimin e dokumenteve të ndryshme sikurse janë certifikatat e notave, diplomat etj. Më shumë i theksuar është në rastet kur administrata e shkollave ka të bëjë me individë të cilët pas një kohe më të gjatë të përfundimit të shkollimit kërkojnë të pajisen me dokumente të ndryshme. Në raste të tilla arsyetimi i administratës është se është shumë e vështirë të gjenden informata e kërkuara, kërkon shumë kohë, është proces i lodhshëm, që në mënyrë indirekte paraqet kërkesë për mito.

- **Regjistrimi në institucionet edukative publike**

Raste të këtij fenomeni që janë raportuar në QAKL kanë pasur të bëjë me regjistrimin në institucionet parashkollore dhe të edukimit të lartë. Qytetarët raportojnë se për shkak të numrit shumë të kufizuar të pranimit të fëmijëve apo studentëve në këto institucione dhe përdorimit të shpeshtë të lidhjeve familjare nga personat tjerë, qytetarët vihen në pozitë që të kërkojnë zgjidhje duke përdorur metodat e lidhjeve familjare, shoqërore dhe korrupsionin. I tërë ky mekanizëm është rezultat i keqpërdorimit të detyrës nga personat në pozitë, mos definimit të qartë të kriterëve të pranimit, mungesës complete të transparencës dhe mungesës

së një sistemi përmes të cilit do të mund të ushtrohej kontroll lidhur me listat.

- ***Shfrytëzim i të mirave materiale të shkollës për nevoja personale***

Nga vendet rurale është denoncuar fenomeni i shfrytëzimit të elementeve materiale të shkollave për nevoja personale. Kështu janë përdorur: stufat, drutë dhe materialet tjera. Ky mekanizëm i korrupsionit fillon me blerjen e materialeve me kërkesë të vetë shkollës, përmes prokurimit publik, e më pastaj të njëjtat pas pak kohe të përdorimi në shkollë merren në shfrytëzim privat. Ky fenomen është rezultat i mungesës së sistemit të inventarizimit dhe mungesës së kontrollit dhe përgjegjësisë.

- ***Ngritja e fondeve me kontribut të nxënësve dhe mungesë transparence***

Praktika e ngritjes fondeve për nevojat e shkollës nga kontributi i vetë nxënësve dhe mungesa e transparencës së shfrytëzimit të atyre mjeteve është po ashtu një indikator i mundësisë së ekzistimit të korrupsionit.

- ***Dyshimet për manipulim të konkurseve për punësim në sistemin Universitar***

Ankesa dhe dyshimet për korrupsion në QAKL-ë kanë nga kandidatë të pakënaqur me përzgjedhjen e studentëve për asistentë. QAKL-ja vlerëson se këto ankesa kanë ardhur si rezultat i mos definimit të qartë të kriterëve për pranim dhe respektimit të po atyre kriterëve nga ana e Universitetit të Prishtinës. Ankesat kanë pasur të bëjnë me rastet kur studentët me notë mesatare prej 9.5 nuk janë pranuar në këto pozita derisa studentët me nota më të ulëta janë pranuar.

Rekomandime:

1. Luftimi i fenomenit të familjarizimit dhe emërimeve pa kritere në sistemin e edukimit;
2. Sistem i kontrollit të konkurseve për vende të reja të punës;
3. Parashikimi dhe krijimi i listave shërbimeve, obligimeve dhe dokumenteve të cilat administrata e shkollave është e detyruar të ofrojë në afate të caktuara kohore;
4. Krijimi i një sistemi unik të inventarizimit dhe mundësisë së kontrollit dhe dhënies së përgjegjësisë për atë sistem;
5. Definimi edhe më i qartë i kriterëve për regjistrime në institucione publike arsimore dhe për punësim në sistemin Universitar

Rast i suksesit - Edukim

Ky rast ka të bëjë me një mësues të cilit nuk iu ishte paguar paga për disa muaj. Problemi qëndronte mbi faktin e pohimit se ishte kundër rregullativës ligjore që individit në fjalë kishte vazhduar të punon më tepër disa muaj pasi kishte mbushur 65 vjet, që është mosha e pensionimit. Koha kur qytetari ka arritur moshën 65 vjeçar ka qenë në mes të vitit shkollor. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, vendimet e të cilit janë obligative, ka konstatuar se në rastin specifik nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit dhe si rezultat Drejtorati Komunal për Arsim ishte i obliguar të kompensonte të gjitha pagat. Sidoqoftë, Drejtorati kishte refuzuar të ekzekutonte vendimin për të paguar pagat e mësuesit. Sipas qytetarit në fjalë, Drejtorati kishte refuzuar të kompensonte pagat e tij për

faktin se, nëse ai do të heshte, shuma e parave që ishin të obliguar ti paguanin do të keqpërdorej nga Drejtorati. Pas marrjes së këtij informacioni, zyra e QAKL-së në Kosovë ka këshilluar qytetarin që ti drejtohej gjykatës për të kërkuar ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Pavarur, pasi një vendim i tillë ka titull përmbarues. Më tutje, për shkak të rrethanave që ndërlidheshin me rastin, zyra e QAKL-së ka ndihmuar qytetarin në hartimin dhe dorëzimin e një urgjence për përshpejtimin e procedurave. Disa ditë më vonë zyra e QAKL-së është informuar se qytetari në fjalë ka arritur të realizojë të drejtën e tij dhe të gjitha pagat i janë transferuar në llogarinë e tij. Me këtë rast ai ka falënderuar QAKL-në TI për ndihmën e ofruar.

SEKTORI PRIVAT

11% të rasteve të raportuara

Korrupsioni në sektorin privat është një shqetësim në rritje për qytetarët në nivel global. Ky shqetësim është i pranishëm edhe tek qytetarët e Kosovës, pasi që sipas Barometrit Global të Korrupsionit 2009, publikuar nga Transparency International (TI), më tepër se 64% e qytetarëve të Kosovës janë të gatshëm të paguajnë më tepër për produktet e kompanive që nuk janë të prekura nga korrupsioni. Kjo e dhënë lidhur me qëndrimin e qytetarëve të Kosovës mund të jetë rezultat i vetë eksperiencës së tyre me korrupsionin në sektorin privat. Andaj edhe në QAKL raportimet për korrupsion lidhur

me sektorin privat bëjnë që ky sektor të radhitet në njërin nga sektorët më të korruptuar.

Në vendet me zhvillim të lartë ekonomik paraqitet edhe korrupsioni që lidhet me ndikimin në politikat shtetërore nga ana e sektorit privat (GCB 2009, TI), andaj edhe Kosova si masë preventive për të ardhmen duhet përgatitur për evitimin e këtij fenomeni.

Ndër praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë:

- ***Përdorimi i praktikave korruptive nga kompanitë private në prokurim publik***

Korrupsioni në sektorin privat kryesisht identifikohet përmes praktikave korruptive që përdor ky sektor në mënyrë që të siguroj kontrata pune a shërbimesh, kontrata këto që ofrohen përmes procesit të prokurimit publik. Në përgjithësi, ekziston perceptimi se në Kosovë pa prezencë të korrupsionit është shumë e vështirë të fitohen kontrata të tilla. Përpos prezencës së korrupsionit në fitimin e kontratave raportohet se sektori privat ndihmon korrupsionin në prokurimin publik edhe përmes lëshimit të faturave mbi vlerën reale. Kjo lidhje në mes sektorit privat dhe korrupsionit në procesin e prokurimit publik analizohet më në detaje në sektorin e funksionimit të korrupsionit në prokurimin publik.

- ***Dhënia e mitos për punësim***

E gjetur shqetësuese e raportit vjetor është praktika e kompanive private që kërkojnë mito me rastin e punësimeve. Kjo ka të bëjë me kushtëzimin e punëtorit që është në kërkim të vendit punës me pagesën e një shume të hollave për atë vend pune. Karakteristike në këto praktika është paraqitja personave të tretë që ofrojnë këtë shërbim në këmbim të mitos për kompaninë

në fjalë, pasi kanë lidhje familjare dhe shoqërore me pronarët e firmave të tilla. Nga rastet e trajtuara nga QAKL-ja individët kanë raportuar se kanë paguar shuma duke filluar nga 500Euro, derisa në raste tjera u janë kërkuar shuma edhe më të mëdha.

- **Keqpërdorim fondesh në shoqëri aksionare**

Nga sektori privat janë raportuar raste të aferave korruptive përmes keqpërdorimit të fondeve të shoqërisë aksionare. Këto shoqëri aksionare kanë lindur pas privatizimit të ndërmarrjeve publike nga vetë punëtorët. Aksionarët kryesorë, duke qenë ata që kanë menaxhuar me kompaninë e caktuar, kanë faturuar shpenzime të paqena dhe kanë rritur vlerën e shpenzimeve reale me qëllim përfitimi personal. Këtë ia kanë arritur edhe duke shfrytëzuar përgatitjen e ulët profesionale të aksionarëve të vegjël dhe mosnjohjen e statusit dhe të drejtave të tyre. Gjatë trajtimit të këtyre rasteve QAKL-ja ka arritur që t'i ndihmoj denoncuesit të cilët kanë arritur t'i realizojnë kërkesat dhe ankesat e tyre.

- **Largim arbitrar nga puna**

Sektori privat paraqitet si institucion ku janë evidente shkelje të mëdha të të drejtave të punëtorëve. Ndërkëto shkelje si shumë të rënda paraqiten edhe largimet arbitrare nga puna. Në disa raste, kur çështja i është drejtuar gjykatës, gjykata ka vërtetuar se largime të tilla kanë qenë arbitrare dhe në kundërshtim me rregullativën ligjore aktuale në Kosovë. Raste tjera që po ashtu i janë drejtuar gjykatës kanë mbetur për vite tëra të pazgjdhura për shkak të mos-efikasiteti të sistemit gjyqësor. Edhe në rastet kur gjykata ka vërtetuar largimin nga puna si të kundërligjshëm probleme në vete kanë mbetur ekzekutimet e vendimeve të tilla. Andaj kjo

fushë paraqitet si shumë problematike dhe të drejtat e punëtorëve mbesin shumë të cenuara.

- **Favorizimi i disa ndërmarrjeve nga organet shtetërore**

Si e dhënë që tregon probabilitet mjaft të lartë të përhapjes së korrupsionit është edhe favorizimi i disa ndërmarrjeve nga organet shtetërore. Kështu në QAKL janë raportuar raste kur disa ndërmarrje operojnë në kushte ku shkelin rregulloret e punës dhe rregullativën ligjore e që nuk kontrollohen e as gjobiten nga organet kompetente. Përderisa, ndërmarrjet tjera u nënshtrohen kontroleve të shumta dhe të tepërta e madje edhe shantazheve të ndryshme duke i detyruar që të kërkojnë zgjidhje përmes korrupsionit.

Rekomandime:

1. Freskimi i listës së zezë të bizneseve, duke përfshirë në këtë listë edhe kompanitë që përdorin afëra korruptive për të fituar kontrata
2. Rishikim i sistemit të sanksioneve për kompanitë që ofrojnë punësime me pagesë, dhe ato që shkelin të drejtat e punëtorëve.

Rast i suksesit nga Sektori Privat

Mbështetja e ofruar nga QAKL për një qytetar i cili pretendonte se ishte larguar nga puna e tij në mënyrë arbitrare, është një tregim i suksesshëm që ndërlidhet me sektorin privat. Për rastin në fjalë gjykata kishte marrë vendimin ku provohej se largimi nga puna ishte arbitrar dhe i paligjshëm, por vendimi i gjykatës nuk ishte ekzekutuar. Pas analizimit

të dokumentacionit dhe konsultimeve me qytetarin në fjalë, zyra e QAKL-së në Kosovë këshilloi këtë të fundit që të sigurojë disa dokumente shtesë të cilat i mungonin për të kompletuar lëndën dhe disa hapa tjerë ligjor që duhet ti ndërmarr. Si rezultat i angazhimit dhe mbështetjes së ofruar nga QAKL qytetari ka arritur të realizojë të drejtat e tij dhe të marrë si kompensim të gjitha pagat që nga dita e largimit arbitrar nga puna dhe pritet për tu kthyer në punë shpejt. Kthimi i tij në vendin e punës nuk ishte i mundur deri më tani pasi në padinë e tij nuk e kishte përfshirë një kërkesë të tillë. Edhe kjo **çështje** është zgjidhur pas këshillimeve të siguruara nga QAKL.

Rast i suksesit – Sektori Privat

Një rast tjetër i suksesshëm që ndërlidhet me sektorin privat, ka të bëjë me një ankesë të një grupi aksionarësh të një kompanie të privatizuar. Ky grup aksionarësh u ankuan se nuk janë duke realizuar përqindjen e tyre të fitimit dhe për më tepër kishin dyshime për korrupsionin në menaxhmentin e kompanisë.

Pas analizimit të dokumentacionit dhe statusit të kompanisë, zyra e QAKL-së në Kosovë i këshilloi të njoftojnë dhe kërkojnë zgjidhje përmes menaxhmentit të kompanisë dhe aksionarëve të mëdhenj, e nëse nuk arrijnë ndonjë marrëveshje lënda të dorëzohet në gjykatë. Duke u bazuar në statusin e kompanisë, QAKL informoi aksionarët për të drejtat e tyre në

mbikëqyrjen dhe kontrollin e shpenzimeve dhe të ardhurave të kompanisë.

Pas konsultave dhe këshillave të ofruar nga QAKL, ky grup i qytetarëve arritën të realizojnë të drejtat e tyre dhe të tërheqin pjesën e fitimeve që tejkalonin disa mijëra euro. Fillimisht kompania kishte refuzuar të njohë të drejtat e këtyre aksionarëve por, përderisa lënda shkoi në gjykatë, ashtu si ishte udhëzuar edhe nga QAKL, kompania vendosi të realizojë të drejtat e tyre. Grupi i aksionarëve u shpreh shumë falënderues për ndihmën dhe këshillat e ofruara nga QAKL.

DREJTAT PRONËSORE

11% të rasteve të raportuara

Barometri Global i Korrupsionit 2009, bazuar në anketimin e qytetarëve dhe eksperiencën e tyre me pagesa të mitos, vjen në përfundim se institucionet që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronave dhe bartjen e tyre janë të dobëta dhe lehtë mund të preken nga fenomeni i korrupsionit, e sidomos në vendet në tranzicion. Në kategorinë e shteteve në tranzicion klasifikohet edhe Kosova, e cila për më tepër ka edhe problemet e veta specifike në fushën e të drejtave pronësore. Proceset e tej-zgjatura gjyqësore të trashëgimisë dhe problemet e shumta që janë në këtë fushë kanë bërë që kryesisht pronat të mos barten dhe të jenë të evidentuara në posedim të personave që realisht nuk i disponojnë ato prona. Zakonisht ende pronat figurojnë në pronësi të gjyshërve apo stërgjyshërve,

apo në raste tjera edhe të jenë stërshitur derisa ende të figurojnë në emër te pronarit fillestar. Veçoritë e Kosovës në këtë fushë dhe fakti se 5% e qytetarëve të Kosovës veçse paguajnë mito tek këto institucione (Barometri 2009), janë pasqyrë shqetësuese dhe tregues të nevojës për vëmendje më të madhe në sektorin e drejtave pronësore.

Praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë:

- **Falsifikimi dokumenteve**

Një fenomen i denoncuar në disa raste në QAKL është falsifikimi i dokumenteve dhe pretendimet në pasuri të ndryshme publike dhe private përmes këtyre dokumenteve. Kështu, në një rast është denoncuar fakti se kopja e planit e lëshuar nga kadastra në Prishtinë ka qenë e modifikuar dhe e ndryshme nga ajo origjinale që pala deklaron se ka arritur ta siguroj në rrugë tjera. Përmes këtij modifikimi në kopjen e planit të lëshuar nga katastri në Prishtinë qytetari pretendon se i është hequr nga posedimi një pjesë e pronës së paluajtshme. Raportime të ngjashme janë bërë edhe me prona të ndryshme publike që janë kaluar në pronësi private, prona të vendosura në vende strategjike sikurse rrugë magjistrale, vendi ku planifikohet ndërtimi i rrugëve me rëndësi etj. Dyskohet se në një mënyrë të tillë, përmes falsifikimit të dokumenteve, ka pasur pretendime edhe për uzurpime tjera të pjesëve të pronave private. Nga qytetarët argumentohet se falsifikime të tilla se bëhen përmes mitos, ose drejtpërdrejt nga persona që punojnë në institucione përgjegjëse me qëllim të përfitimit personal.

- **Fenomeni i mitos tek bartja e pronave**

Institucionet përgjegjëse për vërtetimin e kontratave të shit-blerjeve, të regjistrimit pronave të paluajtshme, apo

të mënyrave tjera të bartjes së pronave, karakterizohen me kërkesa të shumta për këto shërbime dhe me mos efikasitet. Këto kanë si rezultat periudha të gjata kohore dhe radhë të gjata që duhet pritur. Duke parë këtë realitet qytetarët motivohen të kërkojnë zgjidhje përmes rrugëve tjera, përmes mitos apo shfrytëzimit të lidhjeve familjare. Mirëpo qytetarët në QAKL raportojnë edhe sistemin e vendosjes së tyre në pozitë që vetë ata të ofrojnë mito pasi institucionet përkatëse nuk ofrojnë shërbimet me arsyetime dhe kërkesa shtesë e të pa arsyeshme.

- **Pamundësia e shndërrimit nga bartës i së drejtës së shfrytëzimit të përhershëm në pronarë**

Në kohën e sundimit të Kosovës nga Serbia dhe në kushtet e ekzistimit të ekonomisë së centralizuar prona shtetërore ka qenë formë dominante e pronës. Qytetarëve për pronat që i kanë pasur në shfrytëzim iu është njohur e drejta e shfrytëzimit të përhershëm. Për më tepër, tek disa grupe tjera qytetarësh, ata çdo muaj kanë paguar nga një këst në mënyrë që në fund kur edhe e kanë paguar në tërësi t'u bëhet bartja në emër personal. Këto kategori, që kanë mbetur pa paguar ndonjë këst dhe nuk i kanë pronat në emër të tyre, tash hasin shumë probleme që t'i përkthejnë pronat në emër tyre dhe në shumë raste gjykata heziton dhe arsyetohet me mungesa ligjore. Ky fakt dhe pasiguria juridike në të cilën gjenden bën që qytetarët të ofrojnë mito për gjykatësit në mënyrë që të vendosin rastin në favor të tyre.

Rekomandime:

1. Miratimi i ligjit për njohjen e pronësisë së personave që kanë të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm në ato prona. Ligj i cili që në vitin

2005 ishte paraparë të miratohet në Kuvendin e Kosovës

2. Reformimi i administratës dhe rishikim të procedurave për regjistrimin e pronave dhe vërtetimin e kontratave të shit blerjeve në mënyrë që të shmangët korrupsioni në këto institucione

Edhe pse në QAKL numri i rasteve të raportuara në fushën e prokurimit publik nuk pasqyron nivelin e korrupsionit në këtë fushë që perceptohet në opinion publik, informatat e ofruara janë shumë cilësore dhe tregojnë qartë funksionimin e këtyre mekanizmave të korrupsionit. Është me shumë vlerë se informatat lidhur me korrupsionin, në procesin e prokurimit publik, vijnë pothuajse nga të gjitha institucionet.

Praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë:

- *Faturimi mbi vlerën reale*

Duke mos analizuar mënyrën se si një kompani ka fituar tenderin përkatës, për të cilën nuk ka informata, tregues për prezencë të korrupsionit është faturimi dhe pagesa e një produkti të caktuar nga institucioni përkatës publik në shumë moneta më shtrenjtë se sa çmimi i tij real në treg. Është edhe më shumë dekurajues fakti kur shikohen diferenca aq të larta ndërmjet pagesës përmes prokurimit publik dhe vlerës reale të tregut. Kështu QAKL-ja është informuar për një produkt specifik për të cilin institucioni publik ka paguar mijëra euro, derisa vlera e tij, qoftë edhe në tregun e Kosovës, ka qenë shtatë herë më e vogël. Dyshime për korrupsion që kanë lindur nga të dhëna të tilla, por në vlera më të vogla, kanë qenë disa raportime gjatë aktivitetit një vjeçar të QAKL-së.

PROKURIMI PUBLIK

8% të rasteve të raportuara

Prokurimi publik ka kuptimin e procesit të sigurimit të mallrave apo shërbimeve me kushtet më të volitshme nga ana e organizatave që financohen nga paratë e taksapaguesve. Përmes prokurimit publik duhet të operojnë ndërmarrjet që financohen, mbikëqyren ose menaxhohen me mbi 50% të aksioneve nga autoritetet publike.

Si nga kompanitë private ashtu edhe nga opinioni, prokurimi publik perceptohet si fushë me nivel shumë të lartë të korrupsionit dhe që shkakton dëme të mëdha ekonomike. Problemet me prokurim publik përpos në këtë raport vjetor të QAKL-së evidentohen qartë edhe tek raportet e auditorit përgjithshëm dhe raportet e progresit të Komisionit Evropian. Mirëpo problem në vete është mungesa e vullnetit institucional për t'iu qasur në mënyrë serioze luftimit të këtij fenomeni. Kjo duke u bazuar se gjetjet e auditorit ende nuk janë të ndëshkuar edhe pse keqpërdorimet e gjetura janë në shumica të mëdha, përderisa edhe të dhënat dhe vërejtjet e Raportit të Progresit nuk janë marrë seriozisht.

- ***Shpenzime më të mëdha se sa janë faturuar***

Fusha e dytë lidhet me faturimin dhe arsyetimet e shpenzimeve për mallra apo shërbime të siguruar përmes prokurimit publik. Në QAKL është denoncuar fenomeni që ka të bëjë me vlera më të mëdha të shpenzimeve të paraqitura se sa shpenzime për të cilat ekzistojnë arsyetime dhe fatura. Në kuadër të funksionimit të mekanizmave të korrupsionit në këtë fushë, sipas evidencave të QAKL-së, personat përgjegjës në menaxhim rrisin linjat buxhetore të caktuara dhe faturojnë mallra e shërbime për të cilat nuk ekzistojnë dëshmi se janë pranuar. Për të njëjtat raste raportohet se raportet financiare të këtyre projekteve kanë kaluar si të rregullta.

- ***Formimi i komisioneve vlerësuese teknike mbi përshtatshmërinë e ofertës pas dhënies së kontratës***

Në një rast të trajtuar, QAKL-së i janë ofruar fakte sipas të cilave komisioni për vlerësime eksperte të ofertave është formuar pasi që është dhënë tenderi. Përpos që është mos respektim i kushteve të cilat duhet plotësuar për dhënie të tenderit, është tregues potencial i ekzistimit të interesave të ndryshme dhe favorizim i ofertuesit të caktuar.

- ***Pranimi i punëve jashtë standardeve***

Në të shumtën e rasteve përmes prokurimit publik kontraktohet kryerja e punëve të ndryshme infrastrukturore sikurse janë rrugët, objektet edukative, shëndetësore etj. Këto projekte janë projekte me vlera të mëdha monetare që shkojnë në miliona euro. QAKL-ja ka marrë të dhëna të ndryshme, se si produktet finale të këtyre investimeve janë pranuar se janë në nivelin e kërkuar përderisa realisht kanë qenë jashtë standardeve

të kërkuara. Kështu, një qytetar me përgatitje profesionale në fushën e komunikacionit ka raportuar se shtrimi i disa rrugëve është jashtë çdo kriteri duke filluar nga trashësia e bazamentit, lloji i zhavorrit që duhej përdorur, duke kaluar më pastaj në kualitetin asfaltit, disa materiale të veçanta që duhej përmbajtur dhe sasinë e tyre, trashësinë e shtresës së asfaltit etj. Pas një kohe shumë të shkurtë të shtrimit dhe inaugurimit të kësaj rruge, dhe pranimi të punimeve si të rregullta, është raportuar se ka hapje të gropave dhe plasaritje.

- ***Rastet e parregullsive me procedurat tenderuese***

Raste të tenderëve të cilët ipen edhe pse janë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, tregojnë për mundësinë e ekzistimit të interesave personale dhe korrupsionit. Si shembull ilustrues, është rasti kur kontrata i ipet një ofertuesi edhe pse ka qenë i vetmi që ka ofertuar, kështu duke qenë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

- ***Persona në poste publike me ndikim janë fitues të tenderëve***

Indikatorë për mundësi të ekzistimit të aferave korruptive është fitimi i kontratave të ndryshme nga persona me ndikim për shkak të funksioneve të larta publike që kanë, ose kanë pasur. Qytetarët tregojnë, se si janë privatizuar ndërmarrjet nga persona me ndikim në jetën politike, ish-udhëheqës të komunave, gjykatave etj. Në shumë prej këtyre rasteve përflitet për presione ndaj palëve tjera, përdorim të lidhjeve familjare dhe dhënia e mitos.

- ***Ndërprerje e kontratës nga organet jo-kompetente***

Nga numri i përgjithshëm i rasteve në prokurim publik, jo më pak shqetësues mbetet edhe ndërprerja e kontratave nga personat që nuk kanë autoritet për një veprim të tillë. Si rast konkret QAKL-ja ka trajtuar raportimin kur institucioni i kryetarit të komunës i ndërpret kontratën e dhënë përmes prokurimit publik një firme private. Veprim për të cilin kryetari i komunës nuk ka kompetencë.

Rekomandime:

1. Rishikim dhe amendamentim i ligjit mbi Prokurimin Publik bazuar në të dhënat aktuale mbi mekanizmat e zhvillimit të korrupsionit;
2. Implementim i ligjit aktual për prokurim publik
3. Fuqizim të mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave të dhëna përmes prokurimit publik
4. Krijimi i një mekanizmi të veçantë për hetimin e rasteve të dyshuara për korrupsion në kuadër të prokurimit publik
5. Bashkëpunim më të madh ndërmjet Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe Prokurorisë
6. Marrja parasysh e rekomandimeve të dala nga raportet e auditorit
7. Veprimi i menjëhershëm i Prokurorisë ndaj Institucioneve të cilat janë subjekt i parregullive të cilat i paraqet Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Rast i suksesit nga Prokurimi publik

Ky rast ndërlidhet me prokurimin publik, i perceptuar si një nga sektorët më të korruptuar. Një kompani private i është drejtuar zyrës së QAKL-së duke shprehur shqetësime për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës nga ana e kryetarit të komunës. Në më detaje, kompania argumentonte, se komuna kishte vendosur të anulojë kontratën që i kishte dhënë në përputhje me procedurat e prokurimit publik përkundër faktit se nuk gëzon kompetence të tillë. Kontrata ishte anuluar pa arsye, ndërsa kompania mund të dëshmonte se inspeksionet kishin konstatuar se punët e kryera nga kompania janë në përputhje me standardet dhe se kanë qenë duke u realizuar me kohë.

Një tjetër çështje e dyshimtë ishte fakti i dërgesës së një letre, nga ana e kryetarit, të gjitha organeve komunale të asaj komune që asnjë kontratë nuk mund të lidhet me kompaninë në fjalë për shkak të kontesteve që ka ajo me komunën që ai udhëhiqte.

Zyra e QAKL-së, për më tepër u informua se kontrata e njëjtë, pasi iu kishte anuluar kompanisë në fjalë, më pas i ishte dhënë një kompanie tjetër duke shkelur një sërë rregullash procedurale. QAKL u informua se kompania e dytë kishte filluar realizimin e punëve me gjithë faktin se ende nuk e kishte fituar kontratën në mënyrë ligjore dhe në procedurat e parapara. Për më tepër parregullsi në këtë rast, bazuar në

dokumentet e ofruara, komisioni profesional që është përgjegjës për analizimin e ofertave me kushtet e tenderimit është formuar pas datës që kontrata është dhënë kompanisë së dytë.

Kompania në fjalë në fillim kishte kontaktuar me organet komunale me qëllim të zgjidhjes së problemit por nuk kishte arritur sukses. Më pas kishte njoftuar Agjensionin Kundër Korrupsionit, i cili për arsye të panjohura nuk kishte marrë çështjen në konsideratë. Aktualisht çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën Ekonomike. Duke marrë parasysh specifikat e kësaj çështje, zyra e QAKL-së ndërmoi hapat në vijim:

a) Këshilloi kompaninë që në padinë që kishte bërë duhet të përfshijë edhe kërkesën për kompensim të profitit si pasojë e ndërprerjes së paligjshme të kontratës

b) Në raportin gjashtë mujor, zyra e QAKL-së e konsideroi këtë rast si një mekanizëm të korrupsionit dhe njoftoi të gjitha institucionet relevante për dobësitë e institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të procedurave të prokurimit publike dhe ekzekutimin e kontratave, ku EULEX kishte shprehur interesim të **veçantë për raportin në fjalë**. Për më tepër deklarata kryeprokurorit të EULEX gjatë një tryeze të organizuar nga TI lidhur me korrupsionin në gjyqësor, u cituan shumë në media. Ndër të tjera ai deklaroi se në pranverën e këtij viti

pritet të arrestohen disa zyrtarë të lartë për të shkak të përfshirjes në afere të korrupsionit.

c) Duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit, procesi i shqyrtimit dhe analizimit të fakteve është tejzgjatur dhe Gjykata Ekonomike ende nuk ka marrë vendim ndonjë vendim. Një analizë e zhvilluar nga zyra e QAKL në Kosovë ka konstatuar se gjatë vitit 2008 Gjykata Ekonomike ka arritur të zgjidh vetëm 50% të rasteve të dorëzuara. Kjo tregon se efikasiteti i dobët i Gjykatës Ekonomike krijon një ambient të vështirë dhe të rrezikshëm për bizneset, duke ndikuar edhe në pengimin e investimeve të huaja në Kosovë.

INSPEKSION/LICENCA

8% të rasteve të raportuara

Sektori i inspeksionit/licencave sipas raportit vjetor del të jetë fushë ku niveli i korrupsionit është mjaft i lartë. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara ky sektor përfshin 8% të rasteve, dhe përfshihet në rendin e gjashtë prej institucioneve më të korruptuara.

Nga informatat e ofruara rrjedhin përfundimet se dyshimet për korrupsion në këto fusha lidhen me tri fenomene: a) fenomenin e mitos, b) shantazhet e bizneseve dhe c) pranimin e punëve jashtë standardeve. Efekti i korrupsionit në këto fusha është i një rëndësie të madhe. Si më shqetësues paraqitet fakti i shantazheve të

bizneseve dhe vendosjes tyre në pozitë për të korruptuar, fenomen që konsiderohet se e dëmton rëndë klimën për të zhvilluar biznes. Në anën tjetër si rezultat i fenomenit të mitos tek inspeksionet pyjore kemi ambientin shumë të dëmtuar në disa treva. Në këtë sektor përfshihen edhe punët e dobëta e që janë pranuar nga ana e inspeksioneve kinse janë sipas standardeve, të cilat më vonë tregojnë defektet.

- **Praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë: Shantazhi dhe mito ndaj bizneseve private**

Inspektorët e ndryshëm financiar dhe vlerësues të kushteve të punës, raportohet të kenë kërcënuar bizneset me dënime tepër të larta, mbyllje biznesi dhe shumëfishim të parregullsive të gjetura në këmbim të mitos. Kjo është bërë në rastet kur inspektorët kanë gjetur qoftë edhe parregullsi të vogla në biznese. Shumat e mitos të paguara nga bizneset variojnë nga pesëqind euro e më lartë.

- **Vlerësim i kritereve të ndërtimit**

Vendimet e inspeksioneve komunale mbi ndërtimin e disa objekteve shumë katëshe si të rregullta dhe që respektojnë kushtet, lë hapësira për dyshime për korrupsion. Kjo pasi elementë të shumta flasin për të kundërtën duke filluar nga bllokimi i dritës natyrale të objekteve afër, uzurpimi i sipërfaqeve publike e private përreth e deri tek rastet që kanalizimi të kalojë përmes oborreve private afër.

Si indikator tjetër është edhe pranimi i punëve që janë jashtë standardeve, problem ky i trajtuar edhe më lartë. Ky fenomen është i pranishëm sidomos tek rastet e prokurimeve publike, ku inspeksionet duhet të bëjnë

vlerësimin e cilësisë së punimeve. Edhe pse inspeksionet kanë miratuar punime të tilla si cilësore, në raste është vërtetuar e kundërta: gropat e plasaritja e rrugëve, mos funksionim i sistemeve të ndryshme dhe probleme tjera të shfaqura.

- **Mito nga inspeksionet e pyjeve**

Një prej mekanizmave të funksionimit të korrupsionit në sektorin e inspeksioneve ka të bëjë me inspeksionet pyjore, më saktësisht mënyrën e korrupsionit përmes mitos. Raportimet në QAKL tregojnë se në rastet kur inspektorët e pyjeve kapin qytetarë duke bërë prerjen e pyjeve ofrojnë mundësinë që ata të paguajnë një shumë të caktuar të mitos në mënyrë që ata ta heshtin dhe të mos e dërgojnë lëndën në gjykata për kundërvajtje. Nga kjo praktikë tregohet se si janë dëmtuar numër i madh i pyjeve në vendin tonë, apo edhe regjione të tëra (p.sh. rajoni i Jezercit). Në një praktikë edhe më të keqe qytetarët tregojnë lidhje të inspektorëve pyjor me kompani dhe individë privat që gjatë kohës kur ai është në inspektim ata të jenë të lirë të prenë pyjet në këmbim të mitos.

NDËRMARRJET PUBLIKE

5% të rasteve të raportuara

Kjo pjesë e raportit trajton korrupsionin në ndërmarrjet publike në Kosovë që janë si rezultat i periudhës së mëhershme të ekonomisë së centralizuar. Në ndërmarrje publike hyjnë të gjitha ndërmarrjet që janë nën pronësi publike. Ndërmarrjet kryesore dhe më profitabile në

Kosovë janë pikërisht ndërmarrje publike, duke filluar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK), Termokos etj.

Duke u perceptuar si ndërmarrje të të gjithëve/askujt, në përgjithësi në këto ndërmarrje mungon motivimi për përkushtim në punë, efikasiteti dhe profesionalizmi. Nga tërë këto të dhëna më brengosës është niveli shumë i lartë i korrupsionit në këto ndërmarrje. Korrupsioni në këto ndërmarrje zhvillohet përmes këtyre karakteristikave:

Ndër praktikat kryesore për zhvillimin e korrupsionit në këtë sektor janë:

- **Prokurimi publik**

Procesi i prokurimit publik në këto ndërmarrje publike paraqitet si sektori ku më së shumti është i shprehur fenomeni i korrupsionit. Në këto ndërmarrje funksionimi i korrupsionit në prokurim publik është i ngjashëm me përshkrimin e bërë tek mekanizmat e korrupsionit në prokurim publik më lartë. Ndër karakteristikat paraqiten: faturim mbi vlerën reale, shpenzime të regjistruara më shumë se shpenzime për të cilat ekzistojnë prova, parregullsi në procesin tenderimit dhe zgjedhjes së ofertuesit, pranim i punëve jashtë standardeve, apo fitim i tenderëve nga personat me ndikim. Edhe mekanizmat se si skemat e korrupsionit funksionojnë janë të ngjashme me ato të përshkruara në fushën e prokurimit publik.

- **Punësim përmes mitos**

Niveli i lartë i papunësisë dhe kushtet relativisht të mira që ndërmarrjet publike ofrojnë kanë bërë që këto institucione të jenë synim i shumë qytetarëve për vende pune. Duke e shfrytëzuar këtë element në shumë raste raportohet se këto ndërmarrje ofrojnë punësim përmes mitos. Kjo mito është në vlera shumë të mëdha dhe

bazuar në raportimet e qytetarëve shkojnë deri në 5000 (pesë mijë euro) për një vend pune.

- **Fenomeni i familjarizmit dhe largime arbitrare nga puna**

Në shumicën e këtyre ndërmarrjeve raportohet për krijimin e rretheve familjare dhe shoqërore. Fatkeqësisht këto rrethe të krijuara shpeshherë shoqërohen edhe me largime arbitrare të punëtorëve nga puna. QAKL-ja ka trajtuar disa raste të largimeve të punëtorëve nga puna të cilët kanë qenë me përvojë shumëvjeçare, ku disa kanë qenë vërtetë raste të rënda, të cilët kanë përfunduar me ndihma sociale. Fenomeni i krijimit të rretheve familjare dhe punësimeve të reja vërehet sidomos me rastin e emërimeve të reja në pozita të larta, dhe atë në postin e drejtorëve apo menaxherëve kryesor. Pikërisht kjo është edhe periudha kur bëhet largimi i punëtorëve nga puna.

- **Shmangia e faturimit të rrymës në këmbim të mitos**

Fenomeni i marrjes së mitos në këmbim të informatave se si vidhet rryma dhe shmangies së regjistrimit të energjisë së harxhuar është fenomen që lidhet me KEK-un. Në disa raste qendra është informuar se si vetë inkasantët e KEK-ut në teren ofrojnë informata dhe mënyra se si duhet vjedhur rryma, ofrojnë siguri se derisa ata janë në atë territor ata nuk do zbulohen në këmbim të shumave të larta të mitos. Si fakte për këto raportime qytetarët ofronin faturat e energjisë edhe në muajt e dimrit, fatura të cilat nuk e kalonin shumë prej 10 eurove.

SEKTORËT ME PËRQINDJE MË TË VOGËL TË RAPORTIMIT TË KORRUPSIONIT

26% të rasteve të raportuara

QAKL-ja i ka klasifikuar në këtë fushë sektorët e dyshuar për përhapje korrupsioni për të cilët numri i raportimeve ka qenë më i vogël. Ky numër i vogël i informatave nuk lejon nxjerrjen e konkluzioneve mbi funksionimin e mekanizmave të korrupsionit dhe për më tepër nuk lejon që të gjeneralizohen dhe informatat të përdoren si përfaqësuese për korrupsionin në ato sektorë.

POLICIA

3% të rasteve të raportuara

- Pretendime për largim arbitrar nga puna për shkak të interesave të ngushta personale.
- Mos ndërmarrja e masave nga ana e policisë në rastet e prishjes qetësisë publike interpretohet që si shkas ka lidhjet familjare e shoqërore.
- Keqpërdorimit të pozitës së policit për prerje ilegale dhe shitje të druve.

PRIVATIZIMI

3% të rasteve të raportuara

- Parregullsi në procedurat e privatizimit (rasti me vetëm një ofertues).
- Privatizues të ndërmarrjeve janë persona me poste të larta publike, prej nga rrjedh dyshimi për mundësinë e keqpërdorimit të pozitës së tyre.
- Mos përmbushje e kushteve të parapara me spin-off special dhe mos ndërmarrje masave nga organet kompetente, dhe dyshimet e rrjedhura për prezencë të aferave të korrupsionit.
- Abuzime me të drejtat e punëtorëve

SHËNDETËSIA

2% të rasteve të raportuara

Raportimet për korrupsion në shëndetësi kanë ardhur vetëm nga vendet rurale. Raportimet kanë ofruar informata mbi këto afere korruptive:

- Ilaçet që duhet të ofrohen falas, dhe që ofrohen në shumicën e vendeve tjera, në vendbanimin prej nga raportohet nuk ofrohen. Dyshohet për keqpërdorime dhe shitjen e këtyre barnave nga personeli i ambulancës.
- Pacientët referohen në klinika private dhe nuk trajtohen në ambulanca publike.

SHËRBIMET KOMUNALE

2%

- Lëshime të qëllimshme të gabimeve teknike në dokumente me qëllim të vënies në pozitë të qytetarit që të ofroj mito.
- Kërkesë për mito ne rastet e urgjencave në mënyrë që të përshpejtohet procedura për paisje me dokumenta.

DOGANA

1% të rasteve të raportuara

- Dyshime për manipulime dhe keqpërdorime me pagesën që duhet bërë për kalimin në kanalim për dezinfektim në kufi.

TË TJERA

15% e rasteve të raportuara


Në këto sektorë janë përfshirë edhe raportimet rasteve që nuk kanë qenë drejtpërdrejt të lidhura me afera korrupsioni por kanë qenë të lidhura me dyshime për korrupsion, rastet kur u është ofruar këshillim për të shmangur korrupsionin dhe të tjera.

MËNYRA E INFORMIMIT TË QYTETARËVE MBI MEKANIZMAT ANTI- KORRUPSION

Kjo fushë si synim ka, për të kuptuar më mirë mënyrën se si qytetarët informohen për mekanizmat e që merren me luftë kundër korrupsionit, më konkretisht se si kanë dëgjuar për Qendrën për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) ku raportojnë rastet e dyshuara. Gjithashtu, vlen të ceket që mënyra e informimit mund të shërbejë si e dhënë e rëndësishme në të ardhmen kur planifikohet informimi i mëtutjeshëm.

Raporti vjetor tregon një lidhje shumë të ngushtë të publikut kosovar me televizionin si mjet komunikimi. Kështu, në 50% të rasteve të raportuara të korrupsionit, informatat lidhur me QAKL-në si mekanizmin kundër korrupsionit dhe mënyrën se si të kontaktojnë me QAKL-në i kanë marrë nga Televizioni. Mënyra tjera prej nga janë informuar qytetarët kanë përfshirë promovimin direkt në terren (në qytetet e Kosovës), reklama në radio, artikuj në media, poster, dhe palë që janë konsultuar më parë me QAKL-në etj.


Kjo diferencë në mes televizionit dhe mjeteve tjera nuk është rezultat i fokusimit të QAKL-së vetëm në TV, pasi promovimi i punës së QAKL-së dhe numrit telefonik pa pagesë është bërë në mënyrë përafërsisht të barabartë edhe me mjetet tjera.



MËNYRA SE SI QYTETARËT KANË KONTAKTUAR QAKL-në

Linja telefonike pa pagesë është metoda që më së shpeshti është përdorur nga publiku kosovar për raportimin e korrupsionit në QAKL. Kështu telefonin e kanë përdorur 93% të rasteve të denoncuara. Në anën tjetër të gjitha mënyrat tjerat përbëjnë vetëm 7%, ku hyjnë 4% që kanë bërë vizita direkt në qendër, 2% kanë përdorur e-mail dhe 1% letrat postare.

Bazuar në të dhënat e mbledhura në "Raportin Vjetor i Korrupsionit nga QAKL" konkludohet se për raportimin e rasteve të korrupsionit, qytetarët e Kosovës e përdorin telefonin si mjetin më të përshtatshëm dhe më sigurt. Karakteristikat e të gjitha mjeteve të ofruara për komunikim me QAKL-në janë se kanë qenë mjete të lehta dhe të sigurta për tu siguruar anonimiteti. Ndër mënyrat tjera të kontaktimit me QAKL-në janë përfshirë vizita direkt në qendër, posta elektronike, letrat postare.




RAPORTUESIT E KORRUPSIONIT SIPAS GJINISË

Raporti vjetor nxjerr në pah diferenca të mëdha sa i përket gjinisë së personave që denoncojnë raste të korrupsionit. Në Kosovë dominojnë raportuesit e gjinisë mashkullore kundrejt raportuesve të gjinisë femërore. Kështu nga numri përgjithshëm i rasteve të raportuara, 85% të raportuesve kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe vetëm 15% të gjinisë femërore.

Ky numër i vogël i raportuesve femra mund të argumentohet në mënyra të ndryshme. Barometri Global i Korrupsionit i vitit 2007 dhe 2009 ka trajtuar po ashtu një temë të ngjashme dhe ka gjetur se femrat janë më

pak të prirura për të paguar mito(ryshfet), por gjithashtu i njëjti raport tregon gjithashtu se nuk qëndron konstatimi se femrat janë më pak të korruptuara se meshkujt.

Edhe pse tregon për një numër të vogël të raportuesve të gjinisë femërore, rastet që i kanë raportuar kanë qenë të shpërndara në institucione të ndryshme dhe nuk ka pasur ndonjë sektorë specifik ku kanë mundur të koncentrohen ankesat e tyre sikurse as rastet që kanë raportuar nuk kanë qenë të ngjashme.




RAPORTUESIT E KORRUPSIONIT SIPAS VENDBANIMIT

Klasifikim i përdorur nga QAKL-ja lidhur me raportimet e korrupsionit bazohet në kriterin e vendbanimit prej nga thërrasin raportuesit. Sipas kriterëve të Qendrës për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL) kemi ndarjen në lokacione urbane, gjysmë-urbane, dhe rurale. Në kuadër të **lokacioneve** urbane përfshihen qytetet kryesore të vendit (shtatë qytetet e Kosovës), në lokacione gjysmë-

urbane janë përfshirë qytezat e vendit (komunat më të vogla), përderisa fshatrat janë përfshirë në vende rurale.

Përfundimet tregojnë dallime të mëdha në mes të numrit denoncimeve nga vendet urbane me numrin e denoncimeve nga vendet rurale. Denoncimet nga vendet urbane (qytetet kryesore) përbëjnë 47% të numrit përgjithshëm të denoncimeve përderisa raportuesit me vendbanim në vendet rurale përbëjnë vetëm 9% të numrit përgjithshëm të raportuesve.



KONKLUZIONE

Raporti konstaton një gjendje të rëndë të përhapjes së korrupsionit në Kosovë dhe për më tepër konstaton se në fushat kyçe siq janë: gjyqësia, prokurimi publik, dhe çështjet që lidhen me të drejta pronësore. Në këto sektorë ekzistojnë mekanizma mirë të formuar të cilët mundësojnë zhvillimin e korrupsionit.

Bazuar në raportet ndërkombëtare , Kosova tanimë gjendet shumë afër korrupsionit ekstrem. Ky nivel i përhapjes së korrupsionit meriton një vëmendje të posaçme të institucioneve qeverisëse për të ndërmarr masa konkrete drejt luftimit të kësaj dukurie , e cila po i shkakton vendit dëme mjaft të mëdha.

Argumentimi më valid lidhur me nivelin kaq të lartë të korrupsionit në Kosovë dhe mekanizmave aq mirë të formuar duket të jetë ai që lidhet së pari me mungesën e vullnetit politik për ta luftuar këtë dukuri ,me mungesën dhe mangësitë në paketën ligjore kundër korrupsionit , mungesën e instrumenteve të kontrollit dhe parandalimit, dobësinë e organeve që duhet hetuar dhe ndëshkuar praktikat korruptive sidomos të gjyqësisë dhe prokurorisë. Një varg ligjesh duhet kompletohen pasi: Ligji për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë me një sërë elementesh që duhet t'i ketë në mënyrë që të ketë zbatim efikas ende nuk është miratuar, mungojnë ligjet për gjykata dhe prokurori në mënyrë që t'i përgjigjen realitetit të ri të krijuar, mungon ligji i financimit të partive politike, ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë jo ligjore dhe amandamentimi i ligjit për prokurim publik. Në anën tjetër edhe më brengosës është fakti se edhe pse evidentohen shkelje të ndryshme dhe informata për mekanizmat se si zhvillohet korrupsioni, reagimi i institucioneve është i dobët dhe jo efikas për t'i parandaluar dhe për t'i marrë në përgjegjësi zyrtarët.

Dhe në fund kemi sistemin gjyqësor dhe prokurorial të dobët, shumë të paqëndrueshëm nga ndërhyrjet nga jashtë, e që do të duhej të sigurojnë sundimin e ligjit përmes zbulimit dhe dënimit të personave përgjegjës për korrupsion.

Tërë këto të dhëna shërbejnë edhe si një lloj "motivimi" për kryerësit e akteve korruptive për tu marrë me aktivitete të tilla.

Një konkluzion tjetër që del nga ky raport ka të bëjë me radhitjen e sektorëve në këtë raport për të cilat raportimi ka qenë mjaft i mangët edhe pse janë subjekt i nivelit të lartë të korrupsionit. Konkretisht kjo ka të bëjë me sektorin e prokurimit publik , privatizimi t dhe shëndetësisë , e cila po ashtu lidhet me prokurimin publik.

Edhe përkundër faktit se këto sektorë perceptohen nga qytetarët e Kosovës si më të prekurat nga korrupsioni, numri i raportimeve në QAKL ka qenë shumë i vogël. Vërejte për prokurimin publik janë dhënë edhe në Raportin e Progresit të vitit 2009 nga Komisioni Evropian , ku sektori i prokurimit publik shihet si një nga sektorët më problematik sa i përket korrupsionit.

Arsyeja e numrit kaq të vogël të raportimeve për këta sektor është se ;interesi apo benefiti është i dy anshëm, i cilene fund rezulton me fitimin e shumave të mëdha të të hollave, për të cilat ansnjëra palë nuk ka ndonjë arsye që të raportoj. Po ashtu edhe palët tjera që marrin pjesë në procesin e tenderimit e që janë operatorët tjerë ekonomik konkurrent , nuk kane ndonjë motiv për të lajmëruar ndonjë rast përshkak të arsyeve si në vijim: biznesi i tyre mund të kërcënohet duke e humbur edhe shanset tjera të konkurimit , për të cilët edhe nuk ekziston ndonjë mekanizëm mbrojtës , pastaj Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i cili do të duhej të merrej me ankesat e parashtruara nga palët e interesuara është

jo efikas dhe i ndikuar nga jashtë, dhe në fund edhe po që se lajmërohet për ndonjë padrejtësi që do të mund të zgjidhet në gjykatë, rasti do të zgjaste me vite përshkak të mosefikasitetit të gjykatave tona të cilat edhe vet janë subjekt i korrupsionit.

Një tjetër përfundim del se bashkëpunimi i qytetarëve me organet që luftojnë korrupsionin në Kosovë do të mund të ishte në nivel shumë më të lartë, po që se organet përgjegjëse për luftimin e korrupsionit do të kishin treguar ndonjë rezultat në luftimin e kësaj dukurie duke i dënuar ata të cilët kanë kryer vepra korruptive. Mirëpo, në vendet me nivel të lartë të korrupsionit edhe besueshmëria e qytetarëve në institucione është e vogël që rrjedhimisht është tregues se edhe raportimet janë të vogla për shkak se qytetarë i shohin si mekanizma jo efikas.

Në rastet e denoncimeve të aferave më të rënda të korrupsionit qytetarët zakonisht preferojnë anonimitet të plotë madje edhe për vetë qendrën ku raportojnë. Për më tepër QAKL-ja ka trajtuar raste që janë tregues të qartë të nevojës për rritjen e sigurisë së të dhënave e sidomos të ruajtjes së identitetit të individëve që raportojnë. Në Kosovë përgjegjësia e të gjitha mekanizmave anti-korrupsion duhet rritur duke filluar nga Prokuroria, Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, Sektori Jo-qeveritar apo Media, në mënyrë që së paku në aspektin e sigurisë të ngritët besimi i qytetarëve dhe tu garantohet ruajtja e identitetit.

Dhë në fund, një rekomandim i përgjithshëm do të ishte se; për luftimin e korrupsionit, nevojitet një angazhim i madh dhe i shumanshëm Si bazë e mirë do të ishte, ekzistimi i vullneti politik për ta luftuar korrupsionin, e që do mund të shprehet me plotësimin e ligjeve të nevojshme anti-korrupsion, ndërmarrjen e

reformave të thella institucionale, ndryshimin e politikave institucionale për një menaxhim më të mirë, dhe njëkohësisht forcimi organeve që e luftojnë këtë dukuri.

Edhe roli i shoqërisë civile në këtë proces është shumë i madh, rol që do të plotësohet me ofrimin e informatave mbi mekanizmat e korrupsionit dhe avokim për plotësim e infrastrukturës ligjore dhe ndryshimin e politikave institucionale. Po ashtu, për një luftë sa më të fuqishme dhe sa më gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit, kërkohet një angazhim i madh edhe i gazetarëve hulumtues dhe i medieve në përgjithësi, si dhe një opinion kritik kundër korrupsionit, i cili do mund të ndihmonte në mënjanimin e kësaj dukurie.



Në kuadër të Institutit Demokratik të Kosovës funksionon Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore (QAKL), e cila i ndihmon qytetarët në luftën kundër korrupsionit duke ju ofruar viktimave të korrupsionit asistencë teknike në ankesat dhe pakënaqësitë e tyre.

QAKL e refuzon nocionin që njerëzit janë të pa interesuar në ballafaqimin me korrupsionin. Përkundrazi, tregohet që ata do të përfshihen në luftën kundër korrupsionit kur atyre i'u ofrohen mekanizma të thjeshtë, të besueshëm dhe të realizueshëm.



THIRRNË FALAS
0800 201 301

Rr. Rexhep Mala, Nr.33

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel. +381 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.Kdi-Kosova.org



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Gefördert durch Deutschland
Stability pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany

